




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Prishtinë, më 24.04.2026

Drejtoria e Kulturës, Komuna e Prishtinës, në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, hapë

THIRRJE PUBLIKE

Për të gjithë organizatat joqeveritare, individët të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar e fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare, për thirrjen publike të vitit 2026.

1.OJQ-të, individët në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projekt propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore si më poshtë:

- a) **Art vizual – figurativ:** krijim i veprës së re, fuqizim i artistëve të rinj, ekspozitë, hulumtim kuratorial, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

- b) **Trashëgimi kulturore dhe turizëm:** ciceroni i Prishtinës, fushata vetëdijësimi, pjesëmarrje në aktivitete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim i trashëgimisë kulturore në Komunën e Prishtinës, promovim i diversitetit në Komunën e Prishtinës, turizëm kulturor në Komunën e Prishtinës, platforma informative dhe inovacioni teknologjik;
- c) **Shoqëri kulturore -artistike:** mbështetje të aktiviteteve vjetore, blerja e kostumeve, blerja e instrumenteve dhe pjesëmarrje në festivale;
- d) **Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë:** aktivitete mujore, programe arsimore fuqizim i krijuesve të rinj, rezidencë artistike, debate, ligjërata dhe hulumtime;
- e) **Botime:** për fëmijë, për të rinj, romane, tregime, përkthime, mbështetje të personave me nevojë të veçanta dhe hulumtime kulturore;

2. OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi/ objektivat e përgjithshme të kësaj thirrje janë që Komuna e Prishtinës të ofrojë përkrahje për individët dhe OJQ, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, dhe ofron mbështetjen e tyre me transparencë të plotë dhe pa kurrfarë diskriminimi.

Objektivat specifike të thirrjes janë:

1. Të fuqizohen krijuesit e pavarur dhe krijuesit e rinj që veprojnë në Komunën e Prishtinës;
2. Të prodhohen punë të reja kulturore/ artistike;
3. Të ketë shtrirje të gjerë dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në jetën kulturore/ artistike në Komunën e Prishtinës;
4. Të sigurohet mbështetje për institucionet e pavarura kulturore që veprojnë në Komunën e Prishtinës;

5. Të mbështetet puna në grupe dhe bashkëpunimi ndër-disiplinar dhe ndër sektorial;
6. Të përkrahën punë me përmbajtje kritike, të cilat synojnë të sfidojnë pabarazi sociale dhe ekonomike;
7. Të përkrahën punë me përmbajtje Feministe;
8. Të stimulohet inovacioni teknologjik në të gjitha fushat kulturore/artistike;
9. Të inkurajohen personat me nevoja të veçanta për pjesëmarrje dhe prodhim në sektorin e artistik dhe kulturor.

Vlera e planifikuar për të dy thirrjet është 800,000.00 € .

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **500€**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **19,000.00€**.

Afati për dorëzimin e propozimeve është nga dt. **24.04.2026** deri më **10.05.2026**.

Periudha e zbatimit të projektit është deri *në fund të muajit dhjetor 2026*.

1. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për kulturë:

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës;
- OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën e Prishtinës dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Prishtinës;
- Individët të cilët janë rezident të Komunës së Prishtinës;
- OJQ-të dhe individët mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Prishtinës;
- OJQ-të dhe individët, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Prishtinës në këtë thirrje;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete; dhe të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo

institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;

- OJQ-të dhe individët nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Prishtinës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme.
- Si dhe kufizimet e parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Prishtinës.

2. Propozimet dhe dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen vetëm përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>

- Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e kompletuar do të diskualifikohen.
- Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.
- Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit.
- Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në OJQ, apo cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlenë edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
- Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione .
- Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i

dokumente dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në konform legjislacionit në fuqi.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: kultura.pr@rks-gov.net.. Pyetjet mund të bëhet deri me dt. **04.04.2026**.

Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike

Aplikacioni online

Për individ:

- ❖ Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës
- ❖ Vërtetimin/ Konfirmimin e llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- ❖ Çertifikaten/ Vërtetimin e vendbanimit (merret në zyrat e gjendjes civile apo në bashkësi lokale);
- ❖ Deklaratë për financimin e dyfishtë.

Për OJQ-të:

- ❖ Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- ❖ Çertifikata e nr. fiskal;
- ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- ❖ Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- ❖ Vërtetimin që OJQ- nuk kanë obligime tatimore (nga ATK);
- ❖ Deklaratë për financimin e dyfishtë.

Lista e dokumenteve specifike të thirrjes publike sipas kategorive:

1. Art Figurativ:

- Portfolio e artistit/es/kolektivit;
- Prezentim i punimeve që kanë me u ekspozu;
+ (Për instalacione/skulptura/intervenime ne hapësirë publike);
- Koncepti vizual i veprës;
- Pëlqimi paraprak prej drejtorisë për shërbime publike për lokacionin e veprës.

2.Trashëgimi kulturore dhe turizëm:

- Portfolio e organizatës me punë të ngjashme ose linqe të punëve të ngjashme të autorit-es;
- Projekt propozim (Preferohet që në projekt të ketë profesionist të fushës së trashëgimisë dhe të turizmit) ;
- Koncepti vizuel (aty ku është e zbatueshme);
- Ftesa/marrëveshja (kur aplikohet për pjesëmarrje në aktivitete dhe hulumtime);

3.Shoqëri Kulturo- Artistike:

- Link i punëve të mëhershme të SHKA-ve;
- Biografi të shkurtër për ekipet e përfshira në projekt;
- Koncepti i programit artistik(Përshkrim i detajuar);
- Ftesa/marrëveshja (kur aplikohet për pjesëmarrje në aktivitete).

4.Mbështetje të aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë:

- a) Link i punëve të mëhershme të organizatës;
- b) Biografi të shkurtra për individët/ekipet e përfshira në projekt;

- c) Plani i punës për vitin aplikues (Të përshkruhen detajet e gjitha aktiviteteve);

5. Botime:

- a) Biografia e autorit/es;
- d) Recensionit;
- e) Një pjesë e veprës që do të botohet (Nëse ka ilustrime për fëmijë);
- f) Prezantim i ilustrimeve;
- g) (Nëse ka) Marrëveshje e nënshkruar me shtëpinë botuese.

Afati për dorëzimin e propozimeve është deri më **10.05.2026** përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>.

Për ndihmë shtesë lidhur me mënyrën e aplikimit ju lutem klikoni në vegzën <https://www.youtube.com/watch?v=yZezaokDi4E>